



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 21 Qershor 2023

Nr: 666

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË
Z . FLAMUR NOKA DHE ZJ. ALBANA VOKSHI NDAJ "PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË",
PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË
DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë 21 Qershor 2023, unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve mora në shqyrtim çështjen administrative me:

KËRKUES: Z. Flamur Noka, deputet i Kuvendit të Shqipërisë;
Zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë.

SUBJEKT: Partia Socialiste e Shqipërisë

OBJEKT: Shkelje administrative në kundërshtim me parashikimet e nenit 91, të Kodit Zgjedhor

BAZA LIGJORE: Në mbështetje të nenit 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, neneve 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenit 65 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë", vendimit nr. 9, datë 9.3.2021 dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

K O N S T A T O J :

1. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka administruar 2 (dy) denoncime me objekt dhe subjekt të njëjtë, të regjistruara me nr. 109 ID dhe 225 ID.

Data: 21 Qershor 2023

Nr: 666

Ora: 12:00



"Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023"

2. Denoncimi **109 ID**, më kërkues z. Flamur Noka, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, wshtw administruar nëpërmjet shkresës nr. 56 prot., datë 21.2.2023 dhe denoncimi **nr. 225 ID** me kërkues zj. Albana Vokshi, deputet i Kuvendit të Shqipërisë, wshtw administruar nëpërmjet ndërfaqes së denoncimeve në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ku pretendohet se *Partia Socialiste e Shqipërisë ka lançuar një platformë "Aktiv1st" dhe nga 70 mijë persona të regjistruar në këtë aplikacion shumica e tyre janë punonjës të administratës. Ata janë detyruar të regjistrohen dhe të jenë në aktivë me like dhe share në profilet e tyre dhe në bazë të aktivitetit të tyre në këtë platformë shpërblehen me pikë si dhe vlerësohen në pozicionet e punës në bazë të pikëve.*

Në këtë aplikacion ndahen aktivitete politike të PS, ku marrin pjesë ministrat e deputetë të Partisë Socialiste. Punonjësit që kanë denoncuar këto praktika abuzive me përdorimin e administratës për qëllime politike dhe zgjedhore në favor të Partisë Socialiste. Qëllim i këtij aplikacioni është rritja e profilit të Partisë Socialiste në mediat sociale. Aplikacioni "Aktiv1st" shkel të drejtat, liritë e të gjithë atyre që bëhen "aktivistë" me imponim ose detyrim. "Aktiv1sti" është mjet propagande e presioni politik ndaj qytetarëve, administratës qendrore e vendore si dhe një mekanizëm antikushtetues e antiligjor që po përdoret në prag të zgjedhjeve vendore të 14 Majit 2023 nga Partia Socialiste, në shkelje të Kodit Zgjedhor. Aktiv1sti, i cili shkarkohet on line nga Play Store dhe App Store ka akses në të dhënat personale, në fotot, videot, dokumentet, vendndodhjen, adresën e E-mailit, numrin e telefonit, mesazhet etj. Në datë 7 Shkurt 2023, u publikua në internet një listë me emrat dhe vendet e punës të përdoruesve të dyshuar. Kryetari i PS dhe njëkohësisht kryeministri e ka promovuar dhe mbrojtur publikisht atë dhe ka këmbëngulur publikisht se "Aktiv1sti" është thjesht një aplikacion si Facebook etj. Nga një investigim i BIRN, theksohet se aplikacioni është një mjet për të rritur profilin e Partisë Socialiste në mediat sociale, e cila përballlet me zgjedhjet lokale në mes të majit. Platforma "Aktiv1sti" e promovuar nga Partia Socialiste është një krim zgjedhor. Dhe bie në kundërshtim me nenet 123/1, neni 123/2 dhe neni 123/3, të Kodit Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

3. Çështja objekt hetimi administrativ është brenda kompetencave të Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve në bazë e për zbatim të nenit 19, pika 1, shkronja "dh", "f" dhe "n" e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.
4. Mbështetur në përcaktimet e nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator, pasi shqyrtova paraprakisht çështjen, vlerësoj se informacioni apo të dhënat e treguara krijojnë një bazë të mjaftueshme për të nisur hetimin administrativ.
5. Meqenëse në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve janë paraqitur 2 (dy) denoncime nga subjekte të ndryshme dhe meqenëse objekti i shqyrtimit bazohet në të njëjtat fakte dhe bazë ligjore, në mbështetje të nenit 65, shkronja "ç" të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, u vendos shqyrtimi së bashku i këtyre indicieve
6. Në vijim të procedurës administrative, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e ardhura, që sipas denoncuesit përmbajnë fakte dhe rrethana, që mund të përbëjnë shkelje të përcaktimeve ligjore me natyrë administrative në fushën e zgjedhjeve.

7. Njëpërmjet shkresës nr. 1254 prot., datë 2.3.2023, "Partisë Socialiste të Shqipërisë" i është kërkuar informacion në lidhje me denoncimet e administruara.

Për shkak të mos pasjes informacion të mjaftueshëm dhe për shkak të kompleksitetit të çështjes, njëpërmjet vendimit nr. 416, datë 26.04.2023, u vendos zgjatja e afatit të denoncimit ndaj subjekti "Partia Socialiste e Shqipërisë" për shkelje administrative për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023.

8. Partia Socialiste e Shqipërisë, njëpërmjet shkresës nr. 215 prot., datë 10.5.2023, administruar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me shkresën nr. 4919 datë 10.5.2023, i është përgjigjur kërkesës si vijon: *"Partia Socialiste e Shqipërisë është një organizatë politike, ku në qendër të funksionimit të saj ka komunikimin me qytetarët. Pikë së pari, përpara se të ju informojmë në lidhje me procedurat e funksionimit të aplikacionit të hapur online Aktiv1st, ju bëjmë me dije se shkresa datë 21.02.2023, me nr. 991 prot., me lëndë "Ankesë për përhapjen dhe përdorimin e aplikacionit "Aktiv1st" nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë" depozituar në KQZ nga z. Flamur Noka në cilësinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Partisë Demokratike nuk legjitimohet pasi subjekti politik që ai përfaqëson nuk njihet si subjekt zgjedhor nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve dhe për këtë arsye ankesa e bërë nga ana e tij është nul në aspektin ligjor. Në një kohë kur teknologjia evoluon, shpërndarja e mesazhit në kohë sa më reale bëhet më sfiduese, e po ashtu si dhe lufta me lajmet e rreme, ndaj lindi nevoja për të gjetur një mënyrë alternative komunikimi me simpatizantët dhe mbështetësit e Partisë Socialiste, por dhe me këdo që është i interesuar për të marrë informacione mbi aktivitetin e PS dhe të drejtuesve të saj. Duke vlerësuar se kishte nevojë për një pikë ku të përmbilidhej ky informacion në mënyrë ndërvepruese e duke marrë shkas nga mënyrat e komunikimit që përdorin partitë politike, por edhe mediat, në vendet e zhvilluara, Partia Socialiste krijoi një aplikacion me emrin Aktiv1st. Pikërisht ky aplikacion është një nga metodat e reja të komunikimit përveç atyre tradicionale, ndaj dhe aplikacioni Aktiv 1st vjen si një pjesë e modernizimit të vazhdueshëm të Partisë Socialiste dhe një formë komunikimi shumë më i shpejtë brenda familjes sonë politike dhe jo vetëm.*

Aktiv 1st është një aplikacion i hapur online, që shkarkohet lehtësisht nga çdo individ që ndodhet në Republikën e Shqipërisë dhe gjendet në Playstore dhe Appstore për të dyja sistemet e operimit celular Android dhe IOS. Regjistrimi në aplikacion si në çdo aplikacion tjetër, kërkon disa të dhëna bazike që përshtaten me tipologjinë e aplikacionit. Të dhënat e kërkuara po j'uua listojmë si më poshtë me sqarimet përkatëse:

a. *Emër Mbiemër kërkohen për të krijuar emrin e llogarisë së përdoruesit. Këto fusha mund të plotësohen sipas dëshirës së përdoruesit, individ i mund të vendosi edhe pseudonimin e tij, por duhet ti përmbahet kodit të etikës. Në rastin se plotësimi i fushave nuk zbaton kodin e Etikës janë marr masa për mos aprovimin e përdoruesve, pra, individ i nuk mund të regjistrohet në aplikacion dhe të kryejë veprime para se ti aprovohet llogaria.*

- b. E-mail (Adresa e postës elektronike) kërkohet për të krijuar 'username' (kredecialet e përdoruesit), gjithashtu edhe si masë sigurie për përdoruesit në rastin se humbet fjalëkalimin apo nëse individ ka dëshirë ta ndryshojë atë. Në mënyrë automatike i dërgohet një e-mail ku i jepet e drejta të ndryshojë fjalëkalimin. Pra, e-mail ka funksionin si një mjet sigurie të cilin e posedon vetëm përdoruesi.
- c. Fjalëkalimi duke iu referuar botës digjitale dhe teknologjisë, është masa më bazike e sigurisë që mund të kërkohet një përdoruesi në të gjitha tipologjitë e regjistrimeve të krijuara deri më sot, për të siguruar aksesin ekskluziv të përdoruesit në çdo aplikacion apo rrjet social.
- d. Numri i Telefonit kërkohet në fazën e regjistrimit për të pasur një komunikim të drejtpërdrejtë me përdoruesin në rastet kur shpallet fitues në garat e organizuar apo kur nisma e tij është mbështetur masivisht nga përdoruesit e aplikacionit. Duhet theksuar që fusha e numrit të telefonit nuk detyron përdoruesin të vendos numrin e tij të telefonit, mund ta plotësojë atë sipas dëshirës sepse nuk ka një mjet që vërteton nëse numri është i saktë.
- e. Qarku, Bashkia kërkohen në fazën e regjistrimit sepse përveç postimeve që janë në rang kombëtar kemi edhe postimet me filtra sipas qarqeve dhe bashkive. Kjo për arsye që përdoruesit të shohin postimet dhe lajmet nga aktualiteti, në zonën ku ata banojnë.
- f. Adresa e Banimit është një fushë për plotësim të lirë ku përdoruesit mund ta plotësojnë sipas dëshirës, pasi nuk ka asnjë mjet verifikimi mbi tekstin e vendosur nga përdoruesit, por theksojmë se teksti duhet ti përmbahet kodit të etikës, në të kundërt nuk aprovohet si përdorues.

Të dhënat e cituara më sipër të plotësuara nga përdoruesi, përveç emrit dhe mbiemrit të cilat janë emri i llogarisë së tij, nuk shfaqen tek përdoruesit e tjerë. Këto të dhëna qëndrojnë në llogarinë e përdoruesit dhe mund ti shohë vetëm individ i regjistruar dhe nuk shfaqen në asnjë hapësirë tjetër. Të gjitha të dhënat i janë lënë në dorë individit sesi mund të regjistrohet, duke lejuar që çdo përdorues të krijojë një profil e jo domosdoshmërisht të përdorin të dhënat e tyre reale. Në aplikacion tek profili i çdo përdoruesi ekziston opsioni "Fshij llogarinë", ku çdo individ mund të fshijë llogarinë dhe të gjitha të dhënat e tij fshihen automatikisht nga aplikacioni. Ky opsion është një rregull i vendosur nga platformat Playstore dhe Appstore për mbrojtjen e të dhënave dhe çdo aplikacion që publikohet nga këto platforma duhet ta ketë. Gjithashtu ky aplikacion respekton të gjitha të drejtat e rregulluara me ligj të mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë dhe përdorimi i tij nuk përbën shkelje të përcaktimeve ligjore në fushën e zgjedhjeve. Vetë fakti që ky aplikacion është i hapur dhe gjendet në Playstore dhe Appstore dhe mund të aksesohet nga kushdo, **hedh poshtë çdo aludim se ky aplikacion ka për qëllim kontrollin e administratës apo përdorimin e të dhënave personale të qytetarëve. Përsa**

*i përket pretendimeve të Partisë Demokratike për shkelje të Kodit Zgjedhor, vlerësojmë se këto pretendime nuk janë konkrete dhe janë të pabazuara në ligj. Partia Socialiste nuk mund të marrë në konsideratë aludimet dhe akuzat, madje ne jemi mësuar që aludimet dhe akuzat për organizimin e Partisë Socialiste, t'i lexojmë si sinjale të shqetësimit të kundërshtarëve. Lista që ka qarkulluar në media dhe rrjetet sociale është një sagesë që ka pasur për qëllim dezinformimin e qytetarëve. Lista **përmend të dhëna të cilat nuk kërkohen dhe as disponohen nga aplikacioni, fokusi i të cilit është komunikimi masiv, dhe vlerësimi i përdoruesve apo mbështetësve më aktivë.** Për fabrikimin e këtyre të dhënave të manipuluar, Partia Socialiste po ndjek rrugën ligjore. Të gjithë përdoruesit e aplikacionit mund ta shkarkojnë apo edhe fshijnë aplikacionin sipas dëshirës së tyre. Çdo veprim nga momenti i regjistrimit bëhet po ashtu me vullnet të plotë të përdoruesve, pra ata mund të jenë apo jo aktivë, të bëhen pjesë e garave apo jo. Pretendimi se lista me rreth 70 mijë emra që është bërë publike në datën 7 Shkurt është listë e marrë nga aplikacioni është së pari e pavërtetë, pasi mund të verifikohet lehtë se lista është marrë nga lista e pagave, që është bërë publike në fillim të vitit 2021, dhe se ato që pretendohen se janë pikët janë në fakt pagat në atë kohë. Së dyti publikimi i listave apo edhe ekspozimi i personave bazuar mbi bindjet e tyre politike (e dhënë sensitive personale) përbën shkelje të Nenit 7, të ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, e për pasojë Partia Socialiste ka bërë kallëzimin përkatës për këtë vepër. Theksojmë edhe një herë që aplikacioni “Aktiv 1st është një aplikacion që synon komunikimin me publikun për aktivitetin e Partisë Socialiste dhe është i njëjtë me aplikacionet që sot përdoren nga të gjithë mediat edhe në Shqipëri, për të komunikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me qytetarët, i hapur për të gjithë ata që duan të ndjekin e informohen mbi aktivitetin e kësaj force politike. Akuzat dhe përbaltja drejtuar ndaj këtij rrjeti komunikimi online është një sulm tërësisht politik bërë nga kundërshtarët politikë për interesat e tyre meskine.*

9. Nga hetimi i aplikacionit në Apple store dhe playstore, aplikacioni “Aktiv 1st” në përshkrimin e tij thuhet se “Aplikacioni i parë për ata që duan të jenë në zemër të aktivizimit politik. Kjo platformë e Partisë Socialiste të Shqipërisë, i jep mundësinë çdo personi që ka ide dhe dëshirë, të jetë pjesëmarrës në gara lokale ose kombëtare, të çojë përpara nismat e tij, si dhe të jetë një faktor aktiv në komunitetin ku jeton. Aktiv1st është një platformë inovatore, e thjeshtë për tu përdorur nga të gjithë ata që duan të bëhen një zë në shoqëri, duan të jenë nismëtarë ose mbështetës të kauzave në komunitetet e tyre. Platforma është një hapësirë e përbashkët inovative që vlerëson angazhimin dhe iniciativën, si dhe i jep zërin e duhur atyre që duan të kontribuojnë më shumë për të mirën e përbashkët, në nivel lokal dhe kombëtar. Në zemër të aktivizimit politik, në vetëm 3 hapa. Hap profilin tënd dhe bëhu pjesë e një komuniteti virtual, i cili nëpërmjet një sistemi transparent të pikëzimit, vlerëson iniciativën dhe dëshirën për të angazhuar individë me interesa të ngjashme për të arritur më shumë dhe për të çuar përpara kauza të caktuara. Aktiv 1st mbështetet tek një sistem pikëzimi, i cili ndërveprimet me platformën on-line i përkthen në një vlerësim të pasqyruar në “leaderboard”, sipas të cilit do të vlerësohen dhe individët, të cilët shfaqin më shumë iniciativë. Ky aplikacion mundëson që përdoruesi të ushtrojë aktivizmin dhe të informohet në kohë reale, në të njëjtën hapësirë

virtuale. Platforma përfshin dhe një seksion për lajme, duke u bërë një kanal të mirëfilltë informimi, ku lajmet ngarkohen në kohë reale, në mënyrë që përdoruesit të jenë të azhornuar me gjithë zhvillimet e fundit nga politika dhe jo vetëm.

10. Në përfundim të hetimit administrativ, vlerwsoj se:

Në denoncimin e depozituar nga z. Flamur Noka dhe zj. Albana Vokshi, pretendohet se, aplikacioni i nxjerrë nga “Partia Socialiste e Shqipërisë” shkel dispozitat e Kodit Zgjedhor, pasi punonjësve dhe nëpunësve të administratës publike u është ushtruar presion për shkarkimin e këtij aplikacioni, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, nëpërmjet shpërndarjeve, klikimeve dhe postimeve, të vlerësoheshin apo promovoheshin në detyrë dhe njëkohësisht të ndikonin në rezultatin e zgjedhjeve të organeve të qeverisjes vendore, të datës 14 Maj 2023. Gjatë hetimit administrativ, pala denoncuese nuk ka vënë në dispozicion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve asnjë provë për vërtetimin e fakteve të pretenduara dhe që të përbëjnë bazë të mjaftueshme për vërtetimin e shkeljeve të pretenduara.

11. Sipas pwraktimeve të nenit 91, i Kodit Zgjedhor, ndalohet përdorimi i burimeve publike në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje. Po në këtë nen, përcaktohet se burimet njerëzore të institucioneve nuk mund të përdoren në mënyrë të detyruar, brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, apo tu premtohen ose ofrohen përfitime nga pjesëmarrja në aktivitete zgjedhore. Vlerësohet se ushtrimi i presionit ndaj tyre për këtë qëllim do të bënte konstatimin e shkeljes. Denoncuesi pretendon se **kanë ardhur shumë ankesa nga punonjës të administratës publike qendrore e vendore, nga mësues etj., të cilët kanë qenë të detyruar që të hapnin një llogari të tyre në aplikacionin “Aktiv1st” duke u detyruar të japin edhe të dhënat e tyre personale si, emrin, mbiemrin dhe vendbanimin, megjithatë nuk ka pasur asnjë provë konkrete apo bazë të mjaftueshme të dhënash për të vërtetuar mbi presionin e ushtruar.**

12. Në këto kushte për aq sa nuk u vërtetua presioni i ushtruar mbi administratën në shkarkimin e këtij aplikacioni, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi administrativ për mos konstatim të shkeljes së nenit 91, të Kodit Zgjedhor.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, nenet 91, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator në Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

Data: 21 Qershor 2023 Nr: 666
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

1. Pushimin e procedimit administrativ ndaj “Partisë Socialiste të Shqipërisë”.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 21 Qershor 2023 Nr: 666
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ ndaj personave përgjegjës, për shkelje administrative, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”